



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 985/ Prot.  
12

Tiranë, më 31 10 2016

**REKOMANDIM**

Nr. 22 datë 31 10 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit, Hotel "Parlament" Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person fizik,

**KONSTATOVA:**

Në zbatim të Urdhërit Nr.201, datë 20.09.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit Hotel "Parlament" Tiranë, sipas procedurave administrative, me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Hotel "Parlament" p.f., Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.201, datë 20.09.2016 të Komisionerit. Ky kontrollues ushtronte aktivitetin e tij si një biznes familjar, gjë e cila u confirmua nga "Listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, dhe Tatimit mbi të Ardhurat në Punësim", ku punëmarrësit figuronin me të njëjtin mbiemër.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk e kishte kryer Njoftimin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por në datë 27.09.2016, ky kontrollues reagoi duke e përmbushur këtë detyrim.

2. Kontrolluesi nuk aplikon mbikëqyrjen e ambienteve, nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
3. Kontrolluesi nuk aplikon kontrata individuale me punëmarrësit për arsye se është biznes familjar, faktuar sipas: *"Listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, dhe Tatimit mbi të Ardhurat në Punësim"*, ku punëmarrësit figuronin me të njëjtin mbiemër. Duke qënë biznes familjar, nuk krijonin marrëdhënie punëmarrës punëdhënës, për pasojë as marrëdhënie kontraktuale.
4. Kontrolluesi mban një kopje të pasaportës në momentin e regjistrimit të klientit në hotel dhe në momentin e largimit kjo kopje ose i jepet klientit me vete ose shkatërrohet në moment (griset).
5. Nuk konstatohet që kontrolluesi të ketë ndonjë arshivë elektronike me të dhëna personale të klientëve, përveç regjistrave fizikë në të cilët rregjistrohen klientët për efekt të taksës së fjetjes, taksë kjo që monitorohet nga bashkia.
6. Kontrolluesi nuk kryen marketing online (mesazhe promocionale), nëpërmjet postës elektronike apo mesazheve telefonike.
7. Kontrolluesi nuk aplikon politikat e privatësisë në portalin zyrtar: [www.hotelparlament.com](http://www.hotelparlament.com).

**Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 18 dhe 21 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formular Njoftimi i kontrolluesit *Hotel "Parlament"* p.f., Tiranë.
- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i QKR-së.
- Printim nga portali [www.hotelparlament.com](http://www.hotelparlament.com).
- Listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, etj.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se do përmbushin konstatimet e dala nga ky proces verbal.

Zyra e Komisionerit konkludon se, kontrolluesi *Hotel "Parlament"* p.f., Tiranë gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në hoteleri, ka kryer shkelje të nenit 18 dhe 21, respektivisht sipas pikës 1 dhe 7 të konstatimeve nga grupi i inspektimit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson reagimin e menjëhershëm të kontrolluesit dhe bashkëpunimin e tij me grupin e hetimit, i cili ka qënë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi *Hotel "Parlament" p.f.*, Tiranë, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi *Hotel "Parlament" p.f.*, Tiranë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".
3. Kontrolluesi *Hotel "Parlament" p.f.*, Tiranë, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti, në vazhdimësi për pikën e parë të këtij rekomandimi dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dalja e tij, për pikën e dytë.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 31.10.2016

**BESNIK DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**